Kërkuesit: Pronarët: "Pozhegu Brothers" sh.p.k., Avdullah Shahini, Faton, Rabbit, Naser, Jeton dhe Milaim Dërmaku, Valdete Dërmaku Marevci, Mustaf Kadriu, Jahir Ahmeti, Shefket Arifi nga Prishtina dhe Investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të ARBK-së 811251032 dhe përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Gjakova, me kërkesën 05nr.350/03 – 7544/23 dt.12.01.2023 për plotësim-ndryshim dhe zgjerim të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 203396/20 dt.27.01.2022, kanë kërkuar nga kjo drejtori, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit "Froni i Matit" me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa "D1"** me 3B+S+P+10, **"D2"** me 2B+S+P+11 dhe **"D3"** me B+S+P+12 (edhe me Duplex) në lokacionin e përshkruar në paragrafin IV. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën 05nr.350/03 – 7544/23 dt.12.01.2023, për plotësim – ndryshim dhe zgjerim të kushteve ndërtimore dhe për pranim të palës në procedurë, 05nr.350/02 – 203396/20 dt.27.01.2022 dhe plotësuar me shkresat "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/03 – 26645/23 dt.03.02.2023, dhe 05 Nr.070/01-0099935/23 dt. 18.05.2023, si dhe gjatë fazës së trajtimit të kërkesës, është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale: kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale për parcelat kadastrale nr. 824-12, 824-20, 824-22, 824-28, 825-2, 825-7, 825-8, 825-9, 825-10, 825-11, 825-12, 825-13, 825-17, 826-12, 826-27, 827-29, 827-31, 1759-4, & 1791-0 ZK Matiçan, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;
- "Informata nga Plani Rregullues "Mati 1" – PZHU", përmes sistemit Online, me referencë 05nr.350/02–203396/20 dt.03.11.2020, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Fotokopjet e letërnjoftimeve të pronarëve dhe investitorit;
- Incizimin e gjendjes faktike të Bllokut urban "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, punuar nga gjeodeti i liçencuar Burim Halilaj nga Drenasi me licencë nr.195, konstatohet se blloku është realizuar mbi masën nën 50% sipas kriteve të planit rregullues urban;
- Manuali i bashkimit dhe ndarjes, punuar nga gjeodeti i liçencuar Burim Halilaj nga Drenasi me licencë nr.195;
- Fotot e lokacionit dhe ndërtesave ekzistuese;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor", përpiluar te Noter Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.nr.13268/2022 dhe Ref.nr.4784/2022 dt.01.12.2022, e lidhur në mes të Naser Dërmaku, Shefket Arifi dhe Kompania "Pozhegu Brothers"SH.P.K. nga Prishtina;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor", përpiluar te Noter Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.nr.9700/2022 dhe Ref.nr.3146/2022 dt.11.08.2022, e lidhur në mes të Rabit Dërmaku, Milaim Dërmaku, Sejdi Dërmaku dhe Kompania "Pozhegu Brothers"SH.P.K. nga Prishtina;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor", përpiluar te Noter Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.nr.10701/2022 dhe Ref.nr.3588/2022 dt.12.09.2022, e lidhur në mes të Faton Dërmaku, Sejdi Dërmaku dhe Kompania "Pozhegu Brothers"SH.P.K. nga Prishtina;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor", përpiluar te Noter Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.nr.17027/2021 dhe Ref.nr.4632/2021 dt.05.11.2021, e lidhur në mes të Jeton Dërmaku dhe Kompania "Pozhegu Brothers"SH.P.K. nga Prishtina;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtimin e përbashkët të objektit banesor", përpiluar te Noter Sefadin Blakaj në Prishtinë, me LRP.nr.2163/2023 dhe Ref.nr.1018/2023 dt.14.03.2023, e lidhur në mes të Jahir (Ali)Ahmeti, Mustaf Kadriu dhe Kompania "Pozhegu Brothers"SH.P.K. nga Prishtina;
- Projekt propozimin – Projektin konceptual me Situacioni - "zgjdhja urbane" të kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste dhe hapësira të planifikuara, si dhe me projekte ideore, hartuar nga Zyrra projektuese Pozhegu Brothers nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK nr. 811251032;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Pozhegu Brothers nr.0056780/23/93332237135 të datës 16.03.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Avdullah Shahini nr.0133478/23 të datës 27.06.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Jahir Ahmeti nr.0056717/23 të datës 16.03.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Mustaf Kadriu nr.0056760/23 të datës 16.03.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Jeton Dërmaku nr.0057005/23 të datës 16.03.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Rabit Dërmaku nr.0057296/23 të datës 16.03.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Milaim Dërmaku nr.0057273/23 të datës16.03.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Naser Dërmaku nr.0056984/23 të datës16.03.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Shefket Arifi nr.0056993/23 të datës 16.03.2023;
- Vërtetimi i tatimpaguesit Faton Dërmaku nr.0056976/23 të datës16.03.2023;
- Kërkesa për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 1511 të datës 05.05.2023;
- Kërkesa për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 1925 të datës 02.06.2023;
- Dëshmitë e email-ave drejtuar zyrtarëve të AKP-së në lidhje me kërkesat Nr. 1511 të datës 05.05.2023 & Nr. 1925 të datës 02.06.2023.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës 05nr.350/03 – 7544/23 dt.12.01.2023, për **ndryshim-plotësim** dhe **zgjerim** të kushteve ndërtimore dhe pranim të palëve në procedurë, si dhe plotësuar me shkresat "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/03–26645/23 dt.03.02.2023 & 05nr.070/01-99935/23 dt.18.05.2023, me dokumentacionin e prezantuar dhe provave tjera, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për hapësirën -

lokacionin, rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konsultimit të arkivit të drejtorisë për trajtimin e kërkesave për hapësirën - parcelat dhe komplekset ndërtimore në fqinjësi, si dhe projekt propozimit – projektit konceptual me “zgjidhja urbane” të prezantuar, në mënyrë kronologjike konstatoi se:

Kjo drejtori bazuar në kërkesën 05nr.350/02 – 203396/20 dt.03.11.2020 për kushte ndërtimore, me Vendimin 05nr.350/02 – 203396/20 dt.27.01.2022, ka caktuar kushtet ndërtimore në emër të kërkuesve/ pronarëve: “Pozhegu Brothers” sh.p.k., Rustem Krasniqi, Driton Rama, Memedali Nazifi, Faruk Nazifi, Nazmi Jusufi, Sejdi Rexhepi, Arment Dërmaku, Lulzim Rustolli, Hajrullah Etemi, Kudret Arifi, Luan Kastrati, Shpresa Etemi nga Prishtina dhe Investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të ARBK-së 811251032 dhe përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Gjakova, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e Kompleksit “Froni i Matit” me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa “D1” me 3B+S+P+10, “D2” me 2B+S+P+7 dhe “D3” 2B+P+7 në kuadër të pjesës së Bllokut urban “C11”, Tërësia “C” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, nr. 825-1, 825-4, 825-5, 826-13, 827-17, 827-18, 827-19, 827-25, 827-30, 830-3, 830-4, 830-5, 830-6, 830-7, 830-16, 1759-2 & 1759-3 ZK Matiçan, me trajtim përmes kompensimit / shpronësimit me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së parcelës kadastrale nr.825-1, 827-25, 827-30 830-16 & 1759-2 ZK Matiçan, sipas projekt propozimit – projektit konceptual dhe “zgjidhjes urbane”. Këto tri ndërtesa shumë banesore dhe afariste në Kompleksin “Froni i Matit” – **Ndërtesa “C11/D1”** me 3B+S+P+10, **”C11/D2”** me 2B+S+P+7 dhe **“C11/D3”** me 2B+P+7, të miratuara në kushtet ndërtimore të lartcekura kanë këto sipërfaqe ndërtimore: ndërtesa “C11/D1” me sipërfaqe ndërtimore totale  $S=10,498.07m^2$  (mbi tokë  $S=7,182.24m^2$  dhe nëntokë  $S=3,315.83m^2$ ), ndërtesa “C11/D2” me sipërfaqe ndërtimore totale  $S=3,790.64m^2$  (mbi tokë  $S=2,711.75m^2$  dhe nëntokë  $S=1,078.89m^2$ ) dhe ndërtesa “C11/D3” me sipërfaqe ndërtimore totale  $S=4,659.40m^2$  (mbi tokë  $S=3,355.96m^2$  dhe nëntokë  $S=1,303.44m^2$ ), pra gjithsej sipërfaqe ndërtimore  $S=18,948.11m^2$  (mbitokë  $S=13,249.95m^2$  dhe nëntokë  $S=5,698.16m^2$ );

Bazuar në këto kushte ndërtimore, pas procesit të ndarjes/bashkimit të parcelave kadastrale, formohet një parcelë ndërtimore brenda vijës rregulluese që kompensohet me koeficient 3.0, përkatësisht parcela nr.1791-0 ZK Matiçan me  $S=3,681m^2$  (si rezultat i bashkimit të parcelave nr. 825-1, 825-4, 825-5, 826-13, 827-17, 827-18, 827-19, 827-25, 827-30, 830-3, 830-4, 830-5, 830-6, 830-7, 830-16 & nr.1759-3 ZK Matiçan), dhe pas procesit të kompensimit/shpronësimit parcelat dhe pjesët e parcelave nr. 825-1 me  $S=146m^2$ , nr.827-25 me  $S=165m^2$ , nr.827-30 me  $S=167m^2$ , nr.830-16 me  $S=38m^2$  & nr.1759-2 me  $S=220m^2$ , ZK. Matiçan, me sipërfaqe totale prej  $S=736m^2$ , të cilat janë kompensuar me koeficient ndërtimi 3.0, dhe të njëjtat janë shpronësuar bazuar në Vendimin 01nr.400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, sipas Marrëveshjes 13nr.464/01-154310/22 dt.10.11.2022, ku edhe kanë kaluar në pronësi të Komunës së Prishtinës. Ndërsa parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale nr.825-1, 826-13, 827-25 ZK Matiçan me  $S=520m^2$ , kanë mbetur për trajtim në faza tjera, konkretisht në këtë fazë;

Pas kësaj procedure administrative të pajisjes me kushte ndërtimi të lartcekura, investitori “Pozhegu Brothers” sh.p.k. me kërkesën 05nr.350/03 – 7544/23 dt.12.01.2023, ka kërkuar nga kjo drejtori, **ndryshim-plotësim** dhe **zgjerim** të Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 203396/20 dt.27.01.2022, të lëshuara nga po kjo drejtori, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit “Froni i Matit” me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa “D1”** me 3B+S+P+10, **”D2”** me 2B+S+P+11 dhe **“D3”** me B+S+P+12 (edhe me Duplex) në kuadër të pjesës së Bllokut urban “C11”, Tërësia “C” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, si dhe me kërkesat-shkresat “Plotësim dokumentacioni” 05nr.350/03–26645/23 dt.03.02.2023 dhe 05nr.070/01-99935/23 dt.18.05.2023, ka kërkuar pranimin e palëve në procedurë, ku krahas parcelës ndërtimore të formuar me kushtet ndërtimore paraprake nr.1791-0 ZK Matiçan me  $S=3,681m^2$ , janë përfshirë në zgjidhje urbane, edhe parcela të reja: nr.824-12, 824-20, 824-22, 824-28, 825-2, 825-7, 825-8, 825-9, 825-10, 825-11, 825-12, 825-13, 825-15, 825-17, 826-12, 826-27, 827-29, 827-31, 827-32, 827-35, 830-38, 1759-2, 1759-4 ZK Matiçan, prej të cilave, parcelat kadastrale nr.743-2, 746-6, 746-15, 746-21, 746-22, 746-33, 746-58 ZK Matiçan së bashku me parcelën nr.1791-0 ZK Matiçan janë brenda vijës rregulluese si parcela ndërtimore, ndërsa parcelat tjerat jashtë vijës rregulluese për shpronësim sipas vendimeve të lartcekura të shpronësimit 20% & 35% të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Përgjatë diskutimeve e konsultimeve me pronarët e parcelave kadastrale nr. 824-11, 824-12 dhe 824-13 ZK Matiçan, për përfshirjen e tyre në zgjidhje urbane të përbashkët, pronari i parcelës nr.824-12 ZK Matiçan me S=180m<sup>2</sup>, z. Avdullah Shahini ndërkohë ka lidhur kontratë bashkëndërtimi me Investitorin "Pozhegu Brothers" sh.p.k., kontratë e cila është bashkëngjitur në lëndë përmes pranimit të palëve në procedurë, ndërsa të tjerët (pronarët e parcelave nr.824-11 & 824-13 ZK Matiçan) nuk kanë shprehur interesim dhe vullnet të përfshihen në zgjidhje urbane as në kushtet ndërtimore paraprake.

Bazuar në planin e situacionit, parcela kadastrale nr. 824-28 ZK Matiçan me S=181m<sup>2</sup>, me Kushtet ndërtimore 05nr.350 – 169858 dt.17.11.2016, është konsumuar me koeficient ndërtimi dhe është parceluar të shërbejë për qasje në parcelat nr. 824-11, 824-12 & 824-13 ZK Matiçan, kurse me këtë "zgjidhje urbane" kjo parcelë do të ketë këtë funksion vetëm për parcelat nr.824-11 & 824-13 ZK Matiçan, sepse një pjesë e saj do të trajtohet në kompleksin "Froni i Matit" dhe si e tillë nuk është e nevojshme për qasje në parcelën nr.824-12 ZK Matiçan, përkatësisht sipërfaqja e saj prej S=52m<sup>2</sup> do të përfshihet vetëm si sipërfaqe në parcelën ndërtimore brenda vijës rregulluese, pra pa koeficient ndërtimi pasiqë ky koeficient i është kompensuar me kushte ndërtimi 05nr.350–169858 dt.17.11.2016, ndërsa pjesa tjetër me sipërfaqe prej S=129m<sup>2</sup> do të ndahet dhe formohet parcelë me numër të ri kadastral;

Me përfshirjen e parcelës nr. 824-12 ZK Matiçan në "zgjidhje urbane" të Kompleksit "Froni i Matit", vetëm parcelat nr. 824-11 & 824-13 ZK. Matiçan (me pronarë privat të parcelave kadastrale) dhe parcela kadastrale nr. 821-0 ZK Matiçan në pronësi / menaxhim të AKP-së, mbesin të pa trajtuara dhe të pazhvilluara. Andaj, për këtë arsye është kërkuar nga subjekti juridik "Pozhegu Brothers" sh.p.k. të paraqes një propozim zgjidhje për këto dhe njëherë të parashtrojë kërkesë në AKP, të cilën edhe e ka realizuar përmes shkresës së protokolluar me nr.1511 më datë 05.05.2023, përmes së cilës kërkohet një konfirmim nga ana e AKP-së në lidhje me parcelën nr.821-0 ZK Matiçan (në pronësi të AKP-së) nëse është e interesuar të përfshihet në zgjidhje urbane, si dhe të japin pëlqim që ndërtesa e planifikuar "C11-D3" të mund të pozicionohet në kufi të parcelës nr.821-0 ZK Matiçan, pa pasur nevojë të mbajë minimumin e distancës prej 3m' sipas PRRU "Mati 1", meqenëse kjo parcelë ka formë të çrregullt, dhe e pamundëson pozicionimin e ndonjë ndërtese në kufijtë e saj. Kjo kërkesë ka të bashkëngjitur edhe pjesën grafike – "zgjidhjen urbane" të propozuar me ndërtesën e rezervuar/propozuar me sipërfaqe ndërtimore, sipas koeficientit të ndërtimit 3.0 për këto tri parcela të pa trajtuara, gjegjësisht parcelat kadastrale nr. 824-11, 824-13 dhe 821-0 ZK Matiçan, si dhe ndërtesa "C11-D3" e pozicionuar në kufi të parcelës nr. 821-0 ZK Matiçan.

Krahas këtyre parcelave, jashtë zgjidhjes urbane (brenda bllokut urban) mbesin edhe parcelat kadastrale nr.825-6 dhe 827-6 ZK Matiçan (parcela kadastrale me pronarë privat), nr.826-2, 827-8 & 827-11 ZK Matiçan (parcela kadastrale në pronësi të AKP-së). Për përfshirjen e këtyre parcelave kadastrale në zgjidhje të përbashkët urbane është parashtuar kërkesa nga subjekti juridik "Pozhegu Brothers" sh.p.k. e protokolluar me nr. 1925 më datën 02.06.2023 në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke e njoftuar të njëjtën për specifikat e projektit dhe mundësinë e zhvillimit të këtyre parcelave, meqenëse e kanë si mundësi të fundit për t'u përfshirë në një zgjidhje të mirëfilltë urbane. Kjo kërkesë është adresuar edhe nga zyrtari i lëndës më datë 09.06.2023 dhe 13.06.2023 në e-mail-in zyrtar të AKP-së [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org), zyrtarët e AKP-së [vlora.konushevci@pak-ks.org](mailto:vlora.konushevci@pak-ks.org) dhe [veton.hajdini@pak-ks.org](mailto:veton.hajdini@pak-ks.org), në të cilën janë të përshkruara pikat e cekura, si më poshtë:

- pajtoheni që të pronarët dhe investitorit të ndërtojnë në kuadër të parcelës kadastrale nr. 824-12, 824-20, 824-22, 824-28, 825-2, 825-7, 825-8, 825-9, 825-10, 825-11, 825-12, 825-13, 825-15, 825-17, 826-12, 826-27, 827-29, 827-31, 827-32, 827-35, 830-38, 1791-0, 1759-2, 1759-4 ZK Matiçan, sipas projekt propozimit konceptual - Plani i situacionit / "zgjidhja urbane" të prezantuar në këtë drejtori duke mos cenuar parcelat kadastrale nr.821-0, 826-2, 827-8 & 827-11 ZK Matiçan ;
- pajtoheni që këto parcel & pjesë e parcelave kadastrale të trajtohet në Plani i situacionit – "zgjidhje urbane", duke rezervuar një pjesë të hapësirës në parcelën kadastrale nr.821-0, 826-2, 827-8 & 827-11 ZK Matiçan për ndërtim bazuar parametrat urban dhe sipërfaqen e parcelave që përfshihet Brenda vijës rregullues, ku pas privatizimit pronarët/poseduesit e atyre parcelave do të mund të realizonte ndërtimin në marrëveshje me investitorin;
- të privatizohet ajo pjesë e parcelës me ndonjë procedure të përshpejtuar, ose me marrëveshje direkt me investitorin investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k. nga Prishtina;
- të arrihet marrëveshje me investitorin deri në privatizimin e këtyre parcelave kadastrale, apo ndonjë vendimi tjetër;
- apo të gjendet ndonjë formë e pranueshme, e cila do të ju konvenonte dy palëve, investitorit dhe AKP-së, e cila do të mundësonte realizimi i asaj pjese të planit rregullues urban;

Bazuar në kushtet e ndërtimit 05nr.350 – 169858 dt.17.11.2016, për parcelën kadastrale nr. 825-0 ZK Matiçan, me pronar/posedues PSH - KBI Kosova – Export, sipërfaqja me koeficient 3.0 është rezervuar në ndërtesën "C11/B13", me etazhitet 2B+P+13 dhe sipërfaqe  $S=3,200m^2$ . Nga parcela kadastrale nr. 825-0 ZK Matiçan, me pronar/posedues PSH - KBI Kosova – Export, gjatë proceseve të ndarjes/bashkimit dhe privatizimit janë formuar parcelat kadastrale nr. 825-2, 825-6, 825-7, 825-8, 825-9, 825-10, 825-11, 825-12, 825-13 & 826-2 ZK Matiçan, prej këtyre parcelave kadastrale, parcelat nr. 825-2, 825-8, 825-9, 825-12 & 825-13 ZK Matiçan trajtohen si parcela ndërtimore në këto kushte ndërtimore dhe kompensohen me koeficient ndërtimi, parcelat nr. 825-7, 825-10 & 825-11 ZK Matiçan, do të trajtohen vetëm me koeficient ndërtimi në kuadër të Bllokut dhe do të kalojnë në pronësi të Komunës së Prishtinës, meqenëse nuk tangjentojnë me vijën e ngastrës ndërtimore, ndërsa parcela nr. 825-6 ZK Matiçan (në pronësi private) dhe parcela kadastrale nr. 826-2 ZK Matiçan, me pronar/posedues PSH - KBI Kosova – Export, me sipërfaqe  $S= 621.60m^2$  (sipas <http://geoportal.rks-gov.net>), nuk trajtohen me këto kushte ndërtimore;

Meqë parcela bazë në kushtet ndërtimore paraprake me nr.825-0 ZK Matiçan e këtyre parcelave kadastrale me këto kushte ndërtimore aktuale, e ka të rezervuar sipërfaqen ndërtimore mbitokë, te ndërtesa "C11/B13" me etazhitet 2B+P+13, dhe sipërfaqe  $S=3,200m^2$ , sipas Kushteve ndërtimore 05nr.350–169858 dt.17.11.2016, nga kjo sipërfaqe minusohen parcelat kadastrale të lartëcekura që hyjnë në trajtim, përkatësisht kompensim/shpronësim me këto kushte ndërtimore, pra në total parcelat që minusohen kanë sipërfaqe  $S=1,027m^2 \times 3.0= 3,081m^2$ , ndërsa ndërtesa "C11/B13" do të mbetet e rezervuar për parcelën nr. 826-2 ZK Matiçan me pronar/posedues PSH - KBI Kosova – Export, në të cilën tani ka tolerancë për akomodimin e sipërfaqes mbitokë edhe të parcelave kadastrale nr. 827-8 & 827-11 ZK Matiçan me pronar/posedues PSH - KBI Kosova – Export. Ndërsa sa i përket parcelës nr. 825-6 ZK Matiçan në bazë të kërkesës së investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k. në Agjencinë e Privatizimit të Kosovës (AKP) nr. 1925/22 të datës 02.06.2023 së bashku me parcelën kadastrale të patrajtuar ende nr. 827-6 ZK Matiçan (në pronësi private) sipërfaqja mbitokë e të dy parcelave është propozuar të akomodohen në ndërtesën "C11/B16" me etazhitet 2B+P+8+PH. Mirëpo duhet theksuar se ndaj këtyre kërkesave dhe shkresave zyrtare në formë elektronike (e-mail) nuk është kthyer ndonjë përgjigje në lidhje me to nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP); Pra, si përmbledhje, me këtë kërkesë 05nr.350/03 – 7544/23 dt.12.01.2023 për plotësim – ndryshim dhe zgjerim të kushteve ndërtimore, zhvillohen apo trajtohen parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale nr.824-12, 824-20, 824-22, 824-28, 825-2, 825-6, 825-7, 825-8, 825-9, 825-10, 825-11, 825-12, 825-13, 825-15, 825-17, 826-12, 826-27, 827-29, 827-31, 827-32, 827-35, 830-38, 1759-2, 1759-4 & 1791-0 ZK Matiçan, prej të cilave parcelat nr.824-12, 824-20, 824-22, 824-28, 825-2, 825-8, 825-9, 825-12, 825-13, 825-17, 826-12, 826-27, 827-29, 827-31 & 1791-0 ZK Matiçan, janë brenda vijës rregulluese me sipërfaqe totale  **$S=5,804m^2$** , parcelat kadastrale nr.825-7, 825-10, 825-11 do të kompensohen, përkatësisht do tu transferohet koeficienti i ndërtimit 3.0, dhe do të kalojnë në pronësi të Komunës së Prishtinës, ndërsa parcelat tjera nr.824-12, 824-20, 824-22, 824-28, 825-2, 825-6, 825-7, 825-8, 825-9, 825-10, 825-11, 825-12, 825-13, 825-15, 825-17, 826-12, 826-27, 827-29, 827-31, 827-32, 827-35, 830-38, 1759-2, 1759-4 & 1791-0 ZK Matiçan, do të shpronësohen sipas Vendimeve të Kryetarit të Komunës së Prishtinës deri 35% dhe në zgjidhje urbane përfshihen tri ndërtesa shumë banesore & afariste: **Ndërtesa "D1"** me 3B+S+P+10, **"D2"** me 2B+S+P+11 dhe **"D3"** me B+S+P+12 (edhe me Duplex) në kuadër të Bllokut urban "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë.

Bazuar në parcelat kadastrale të përfshira jashtë vijës rregulluese – hapëira publike, konstatohet se: parcela e formuar ndërtimore brenda vijës rregulluese për këtë bllok është  **$S=5,752m^2$**  ( $S=5752 \times 3.0=17,256m^2$ ) si dhe me pjesën e parcelës kadastrale nr.824-28 ZK Matiçan me  $S=52m^2$  (e cila nuk trajtohet në koeficient të ndërtimit) ndërsa parcelave kadastrale me sipërfaqe  **$S=432m^2$**  do t'iu transferohet koeficienti i ndërtimit, përkatësisht  **$S=432 \times 3.0=1,296m^2$** . Sipas Vendimit të Kushteve ndërtimore 05nr.350/01–203396/20 dt.27.01.2022, dhe me aplikimin e Vendimit, 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, është kompensuar prona private, e përfshirë në rrugë të planifikuar të planit rregullues, deri në 20% të parcelës ndërtimore  $S=3681m^2$ , me  $S=736m^2$  (parcelat kadastrale nr.825-15 me  $S=146m^2$ , nr.827-32 me  $S=165m^2$ , nr.827-35 me  $S=167m^2$ , nr.830-38 me  $S=38m^2$  & nr.1759-2 me  $S=220m^2$  të shpronësuar me Marrëveshjen 13-464/01-154310/22 dt. 10.11.2022), sipërfaqe e cila është kompensuar me koeficient ndërtimi  **$S=736 \times 3.0=2,208m^2$** .

Bazuar në parcelën ndërtimore me sipërfaqe prej  $S=5,752m^2$ , duke mos llogaritur pjesën e parcelës kadastrale nr.824-28 ZK Matičan me  $S=52m^2$  (e cila do të llogaritet vetëm si sipërfaqe ndërtimore brenda vijës rregulluese pa koeficient ndërtimi), për shpronësim sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 14nr.464/01 – 97987/22 dt.05.05.2022 ( 20% & 35%) do të merret vetëm sipërfaqja prej  $S=5,752m^2$  (20% & 35%), ndërsa sipërfaqja e parcelave kadastrale jashtë vijës rregulluese dhe brenda bllokut urban (të cilave do t'iu transferohet vetëm koeficienti dhe do të kalojnë në pronësi komunale) me  $S=432 m^2$  do të llogaritet për shpronësim deri 20%, ku detalisht do të sqarohet më poshtë shpërndarja e sipërfaqeve me shpronësimet përkatëse:

Në ndërkohë Subjekti juridik "Pozhegu Brothers" sh.p.k. nga Prishtina përmes kërkesës 05 nr. 351/02 –43235/23 dt. 28.02.2023 ka kërkuar leje ndërtimi për ndërtimin e Ndërtesës "C11/D1" me etazhitet 3B+S+P+10 dhe sipërfaqe ndërtimore totale  $S=11,293.86m^2$  (mbitokë  $S=7,377.84m^2$  dhe nëntokë  $S=3,916.02m^2$ ), e cila kërkesë është në procedurë të shqyrtimit dhe trajtimit.

Po ashtu në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit nga ana e zyrtarit përkatës në kuadër të drejtorisë për komunikacion dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit, është përcaktuar dhe konfirmuar rregullsia dhe kyçja në kompleks në aspektin e komunikacionit, si dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren për kyçje të kompleksit në rrugën e brendshme të bllokut dhe e njëjta me rrugën e planifikuar.

*Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të "Pozhegu Brothers" shpk., në lagjen "Mati 1", në Prishtinë, lidhur me kërkesën për plotësim të kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/03-7544/23 të dt. 12.01.2023, kyçjet për automjete për kompleksin afaristo – banesor, objekti C11/D1 me etazhitet -3B+S+P+10, objekti C11/D2 me etazhitet -3B+S+P+11 dhe objekti C11/D3 me etazhitet -3B+S+P+11, në rrugën e cila është e paraparë me Planin Rregullues "Mati 1", sipas zgjidhjes së prezantuar mund të pranohet si e tillë, marrë parasysh lokacionin e kësaj zgjidhje urbane, dhe shmangien e kyçjeve në raport me udhëkryqet e rrugëve të planifikuara. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimi në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m, si dhe të parashihet mundësia e përballkalimit të lirë në mes të automjeteve. Kyçjet duhet të harmonizohen dhe të përshtaten me profilin e rrugës së planifikuar dhe në kohën kur realizohet ajo sipas planit.*

Bazuar në konstatimet e mësipërme, dokumentacionin e shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, si dhe nenit 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", dhe diskrecionin për vendosje të çështjeve të planifikimit dhe ndërtimit në bazë të neneve 4, 21, 22 dhe 57 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L - 031 dt.21.07.2016, lidhur me ligjshmërinë për rihapjen-rishqyrtimin e procedurës, shfuqizimin e Kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 203396/20 dt.27.01.2022, ri-caktimin e kushteve ndërtimore sipas rrethanave të reja, dhe zbatimin e Vendim, 14nr.464/01– 97987/22 dt.05.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, si dhe Vendim, 14nr.350/05 – 0069714/18 dt.22.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, "Për Përcaktimin e Mënyrës së Zbatimit të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Zonat Urbane", Drejtorja e Urbanizimit konstatoi se kërkuuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se kërkesa 05nr.350/03 – 7544/23 dt.12.01.2023 e kërkuësve/pronarëve: "Pozhegu Brothers" sh.p.k., Avdullah Shahini, Faton, Rabbit, Naser, Jeton dhe Milaim Dërmaku, Valdete Dërmaku Marevci, Mustaf Kadriu, Jahir Ahmeti, Shefket Arifi nga Prishtina dhe Investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të ARBK-së 811251032 dhe përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Gjakova, dhe plotësuar me kërkesat - shkresat "Plotësim dokumentacioni" 05nr.350/03 – 26645/23 dt.03.02.2023 dhe 05nr.070/01-99935/23 dt. 18.05.2023, për pranim të palëve në procedurë, mund të miratohet dhe të ri-caktohen kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **Kompleksit "Froni i Matit"** me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa "D1"** me 3B+S+P+10, **"D2"** me 2B+S+P+11 dhe **"D3"** me B+S+P+12 (edhe me Duplex) në kuadër të pjesës së Bllokut urban "C11", Tërësia "C" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, ku krahas parcelës ndërtimore të formuar me kushtet

ndërtimore paraprake nr.1791-0 ZK Matiçan me  $S=3,681m^2$ , janë përfshirë edhe parcela të reja në zgjidhje urbane: nr. 824-12, 824-20, 824-22, 824-28, 825-2, 825-7, 825-8, 825-9, 825-10, 825-11, 825-12, 825-13, 825-15, 825-17, 826-12, 826-27, 827-29, 827-31, 827-32, 827-35, 830-38, 1759-2, 1759-4 ZK Matiçan, prej të cilave parcelat kadastrale nr.743-2, 746-6, 746-15, 746-21, 746-22, 746-33, 746-58 ZK Matiçan së bashku me parcelën nr.1791-0 ZK Matiçan janë brenda vijës rregulluese si parcela ndërtimore, ndërsa të tjerat jashtë vijës rregulluese për shpronësim sipas Vendimeve të lartcekura të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe projekt propozimit konceptual të prezantuar.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Gjithashtu, përmes shkresës, "Njoftim" 05nr.350/03-7544/23 dt.13.07.2023, kjo drejtori vendosi që bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht Ligjin Nr.03/L-215 për Qasje në dokumente publike, palët e interesuara, Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP, ti informojë se kjo drejtori me Vendim 05nr.350/02 – 203396/20 dt.13.07.2023 ka ri-caktuar kushte ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacioni - "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara dhe hapësirat përcjellëse; Situacioni i parcelës kadastrale me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues "Mati 1" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01; Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale, punuar nga gjeometri i licencuar Burim Halilaj nga Drenasi, me licencë nr.195.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

**I dërgohet:** Kërkuarit/investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05nr.350/03 – 7544/23 dt.12.01.2023, Drejtorisë për Pronën.

**I dërgohet përmes postës elektronike:** Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, dhe Drejtorisë për Planifikim Strategjik.

**Të informohen:** Me shkresën informuese "Njoftim" 05nr.350/03-7544/23 dt.13.07.2023, të njoftohet Agjencia Kosovare e Privatizimit / AKP-ja.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05NR.350/02 – 203396/20 DT.13.07.2023**

Zyrtari:  
Ergyn Hajredini

Udhëheqëse e Sektorit:  
Nazife Krasniqi

Drejtori:  
Arbër Sadiki












Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01




Punoi:  
Kushtrim Domaneku

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Prishtinë: 13.07.2023

Legjenda:

-  Vija Rregulluese sipas PRRU
-  Vija Ndërtimore sipas PRRU
-  Parcelat Kadastrale



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: \_\_\_\_\_

Zona kadastrale / Katastarska zona: Matiçan

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_


Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelle

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1700

MANUALI GJEODEZIK – PROPOZIM PËR KUSHTE NDERTIMORE



Lista e koordinatave		
Nr	Y	X
1	7514248.187	4722735.849
2	7514248.326	4722735.828
3	7514249.230	4722735.690
4	7514250.230	4722735.541
5	7514272.727	4722732.199
6	7514271.470	4722728.328
7	7514271.004	4722726.782
8	7514269.450	4722721.820
9	7514272.960	4722720.870
10	7514291.046	4722716.109
11	7514290.580	4722714.930
12	7514293.810	4722714.080
13	7514299.364	4722712.664
14	7514294.990	4722704.260
15	7514286.020	4722689.430
16	7514280.670	4722678.990
17	7514292.330	4722671.200
18	7514280.072	4722649.675
19	7514283.514	4722647.648
20	7514301.112	4722637.286
21	7514290.000	4722631.490
22	7514278.240	4722625.330
23	7514273.412	4722623.561
24	7514272.603	4722623.733
25	7514270.447	4722623.915
26	7514266.100	4722624.281
27	7514261.066	4722624.705
28	7514260.816	4722624.725
29	7514255.150	4722625.180
30	7514249.480	4722625.230
31	7514247.160	4722625.250
32	7514238.357	4722625.131
33	7514230.120	4722625.020
34	7514228.250	4722624.730
35	7514224.963	4722628.646
36	7514228.231	4722648.143
37	7514228.064	4722648.153
38	7514228.493	4722649.708
39	7514232.083	4722671.126
40	7514234.884	4722687.841
41	7514235.040	4722688.770
42	7514247.915	4722734.429



Rilevoi / Snimio: BURIM HALILAJ  
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/konpanisë/ Ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ Ime i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 195

Nënskrimi / Potpis: BHalilaj

Data e rilevimit / Datum snimanja: 11.07.2023



Nënskrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: \_\_\_\_\_

Zona kadastrale / Katastarska zona: Matiçan

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_


Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelle

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1700

MANUALI GJEODEZIK – PROPOZIM/PER KUSHTE NDERTIMORE



Lista e koordinatave		
Nr	Y	X
1	7514248.187	4722735.849
2	7514248.326	4722735.828
3	7514249.230	4722735.690
4	7514250.230	4722735.541
5	7514272.727	4722732.199
6	7514271.470	4722728.328
7	7514271.004	4722726.782
8	7514269.450	4722721.820
9	7514272.960	4722720.870
10	7514291.046	4722716.109
11	7514290.580	4722714.930
12	7514293.810	4722714.080
13	7514299.364	4722712.664
14	7514294.990	4722704.260
15	7514286.020	4722689.430
16	7514280.670	4722678.990
17	7514292.330	4722671.200
18	7514280.072	4722649.675
19	7514283.514	4722647.648
20	7514301.112	4722637.286
21	7514290.000	4722631.490
22	7514278.240	4722625.330
23	7514273.412	4722623.561
24	7514272.603	4722623.733
25	7514270.447	4722623.915
26	7514266.100	4722624.281
27	7514261.066	4722624.705
28	7514260.816	4722624.725
29	7514255.150	4722625.180
30	7514249.480	4722625.230
31	7514247.160	4722625.250
32	7514238.357	4722625.131
33	7514230.120	4722625.020
34	7514228.250	4722624.730
35	7514224.963	4722628.646
36	7514228.231	4722648.143
37	7514228.064	4722648.153
38	7514228.493	4722649.708
39	7514232.083	4722671.126
40	7514234.884	4722687.841
41	7514235.040	4722688.770
42	7514247.915	4722734.429



- Legjenda
- Parcela ndërtimore brenda V.R.R. S=6762m² + 62m²
  - Parcelat për shpronësim 20%
  - Parcelat për shpronësim 35%
  - Parcela ndërtimore e shpronësuar me 20% - Udhëzimi i K.N. faza 1 (S=730m² - 20%)
  - Parcela ndërtimore për shpronësim 20%
  - Parcela ndërtimore për shpronësim 35%
  - Parcelat të shpronësuar me K.H. faza 1 (S=730m² - 20%)
  - Parcelat për shpronësim me plotësim K.N. faza 2 (S=450m² - 20%)
  - Parcelat për shpronësim me plotësim K.N. faza 2 (S=450m²) Rruga "A" -35%
  - Parcelat që kompensohen vetëm me koeficient 3.0, që nuk hyjnë në parcelat ndërtimore
  - Pjesa e parcelës nr. 824-28 ZK Matiçan tërësisht në parcelat ndërtimore vetëm në sipërfaqe brenda vijës rregullative në koeficient ndërtimi më të vogël, mënyrë e shpronësimit është korrikual me kushtet e ndërtimit 05-350-100000 dt. 17.11.2014

Rilevoi / Snimio: BURIM HALILAJ  
(emri dhe mbiemri i gjeodezit/kompanisë/ imi e prezime geodeta/ kompanije)  
Nr. i licencës / Br. licence: 195  
Nënshkrimi / Potpis: BHalilaj  
Data e rilevimit / Datum snimanja: 11.07.2023



Aprovi / Usvojio: \_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri i përsonit zyrtar/ imi e prezime shërbënorit)  
Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_  
Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_